



Nevila Dalipi, Këshilltare pranë Njësisë së Mbështetjes së Komisioneve, pranë Departamentit të Shërbimeve Ligjore.

Znj. Dalipi ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në vitin 2001 pranë “Universitetit të Tiranës”.

Në vitin 2008 është diplomuar në profilin marketing, në degën “Menaxher marketingu”, në Universitetin “Ismail Qemali”, Fakulteti i Ekonomisë dhe Drejtësisë (dega biznes), Vlorë.

Në vitin 2011, ka përfunduar studimet Master Shkencor për "E Drejtë Publike".

Përvoja e saj e punës në vitin 2001 fillon si asistente e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Duke vijuar më pas, në vitet 2001-2005 në detyrën e juristes në Kryeministri.

Në vitet 2008-2018 ka punuar në detyrën e specialistes në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, institucion në varësi të Kryeministrit.

Në vitet 2018-2019 ka punuar në detyrën e specialistes në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, institucion në varësi të Kryeministrit.

Gjatë karrierës profesionale është angazhuar në organizma jo-qeveritare të shoqërisë civile me fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Prej vitit 2018 është Koordinatorë për marrëdhëniet me median në Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit.

Znj. Dalipi zotëron licencën e Avokatit, Përmbauesit Privat dhe Licencën e Ndërmjetësimit.

Ka marrë pjesë në trajnime dhe kurse pasuniversitare të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), The Word Bank Institute, Fondacioni Shqipëria e Hapur, ITAP, Akademia Diplomatike Shqiptare dhe institucione të tjera.